




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7129/24 datë: 19.03.2024



Npi – 01/117 datë: 28.03.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe nenin 17 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Neni 8 i ligjit Nr. 03/L-068, për Arsimin në Komunitet dhe Republikës së Kosovës; Neni 7 pika (3.1) e Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; Si dhe duke analizuar propozimin Nr.02/201 datë: 20.03.2024 të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 28.03.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 1500m² SIPËRFAQE PËR NDËRTIMIN E KOPSHTIT PËR FËMIJË NË FSHATIN PETROVË

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 28.03.2024, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për ndarjen e sipërfaqes (truall) për ndërtimin e Kopshtit për Fëmijë në fshatin Petrovë, me sipërfaqe prej: 1500m² (15 ari), në pjesën e ngastrës kadastrale me numër: P-72809066-01012-1, Zona Kadastrale - Petrovë, Evidentuar Pronë e Komunës së Shtimes.

II

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës së Shtimes më datën 30.06.2022 ka miratuar vendimin Npi-01/190 me të cilin janë ndarë 700m² sipërfaqe për ndërtimin e Kopshtit në fshatin Petrovë në ngastrën kadastrale Nr.1012-1, Z.K-Petrovë. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës (MASHTI) pasi ka shqyrtuar anën ligjore të këtij vendimi, ka konstatuar se sipërfaqja prej 700m² nuk është e mjaftueshme për Kopsht, dhe ka propozuar që sipërfaqja të rritet në 1500m², me çka do të plotësohej kushti fillestar për ndërtimin e Kopshtit. Kuvendi e ka shqyrtuar propozimin e Ministrisë dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi që ta ndryshojë vendimin Npi-01/190 të datës 30.06.2022, duke e rritur sipërfaqen nga 700m² në 1500m².

III

Me këtë Vendim Shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/190 të datës: 30.06.2022 për ndarjen e 700m² truall për ndërtimin e Kopshtit për Fëmijë në fshatin Petrovë.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi